



Shkolla fillore në kantonin e Cyrihut

Informacione për prindërit

Shkolla fillore në kantonin e Cyrihut

Qëllimet dhe objektivat

Shkolla publike fillore në kantonin e Cyrihut detyrohet të përmbushë parimet demokratike themelore të shtetit. Ajo është neutrale në çështjet fetare dhe politike. Frekuentimi i shkollës publike fillore është falas.

Shkolla fillore edukon në një sjellje të orientuar në vlera kristiane, humaniste dhe demokratike. Ajo përkrah njësoj si vajzat ashtu edhe djemtë. Ajo plotëson edukimin në familje.

Shkolla fillore përçon njohuri bazë dhe aftësi; ajo çon në njohjen e rethanave. Ajo përkrah respektin para bashkëqytetarëve dhe mjedisit dhe vë si qëllim zhvillimin e plotë të fëmijëve në njerëz me aftësi të pavarura dhe shoqërore..

Të gjithë fëmijët me banim në kantonin e Cyrihut kanë të drejtë të frekuentojnë shkollën fillore publike. Detyrimi shkollorë zgjat nëntë vjet (nga 2008/09: njëmbëdhjetë vjet), por më së gjati deri në përfundim të shkollës fillore. Ai mund të plotësohet nëpërmjet mësimit privat ose në shkollat private.

Fillimi i detyrimit shkollorë

Fëmijët, të cilët deri më 30. prill të një viti kanë mbushur 4-vjet, për ta bëhet fillimi i vitit tjetër shkollor i detyrueshëm dhe frekuentojnë kështu nivelin e kopshtit. Këshilli ndërmjetësues i shkollës planifikon ndarjen e fëmijëve nëpër shkolla.


Viti shkollorë

Viti shkollorë fillon në mes të gushtit dhe zgjat deri në fillim të qershorit të vitit të tjetër. Mësimi ndërpritet nëpërmjet pushimeve të vjeshtës, krishtlindjeve, sportit, të fillim vitit dhe atyre verore. Mësimi zgjat 39 javë kalendarike

Një ditë e zakonit shkollorë

Mësimi ose kujdestaria zgjat paradite prej orës 8 deri më orën 12. Për shkaqe organizative mund të ketë një ndryshim prej 20 minutash (p.sh. fillimi i mësimit në orën 8:20). Mbasditeve fëmijët kanë planet e tyre mësimore individuale. Prindërit kanë të drejtë që ti lënë fëmijët e tyre në përkujdesje për tërë ditën. Për këto oferta prindërit duhet ti mbartin vetë shpenzimet.

Prej kopshtit në ciklin e ulët –te cikli i lartë



Cikli i kopshtit zgjat dy vjet

Cikli i kopshtit përkrah dhe zgjeron edukatën familjare. Ajo përkrah aftësitë, zotësitë dhe talentet e veçanta dhe udhëheq fëmijët me përkujdesje që të ndjehen mirë në grupet më të mëdhaja sociale. Ky cikël i përgatit fëmijët në lidhje me kërkesat shkollore.

Cikli i ulët zgjat gjashtë vjet

Fëmijët gjashtë-vjeçarë pranohen në ciklin e ulët që zgjat gjashtë vjet. Të gjithë fëmijët në ciklin ulët, e frekuentojnë së bashku mësimin pavarësisht nga prejardhja, gjinia dhe nga rezultatet e tyre shkollore. Mbas tre viteve, ndërohet sipas rregullit mësuesi përgjegjës i klasës dhe mundësisht edhe përbërja e klasës.

Cikli i ulët jep njohuri themelore në lexim, shkrim dhe llogaritje, pra në matematik, në gjuhët gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht. Shkrimi, punimi i dorës, vizatimi dhe muzika, sporti, njeriu dhe natyra janë lëndë të tjera të rëndësishme.

Cikli i ulët ndërmjetëson njohuri bazë në lexim, shkrim dhe llogaritje, pra në matematikë, në gjuhët gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht. Shkrimi, puna me dorë, vizatimi dhe muzika, sporti, njeriu dhe mjedisi janë të tjera lëndë të rëndësishme.

Dy herë në vit fëmijët marrin një deftesë shkollore, e cila dëshmon sukseset e tyre shkollore, sjelljen e tyre në punë dhe mësim dhe sjelljen e tyre sociale.

Fëmijët të cilët kanë aftësi të kufizuara intelektuale ose personale marrin përkrahje nëpërmjet masave të veçanta pedagogjike, të cilat arrihen me një marrëveshje me prindërit.

Në fund të ciklit të ulët, fëmijët ndahen në bazë të rezultateve në njërin prej dy ose tre degëve të ciklit të lartë. Fëmijët me sukses të veçantë shkollorë, regjistrohen në gjimnaz, ata pranohen aty mbas dhënies së provimit pranues. Me këtë ata e mbyllin shkollën fillore dhe përmbushin kështu tre vitet e tyre të fundit të shkollës të detyrueshme në gjimnaz.

Cikli i lartë tre vjeçarë ndahet në degët për fëmijët me rezultate të larta dhe për ata me rezultate të dobëta

Cikli i lartë e thellon dhe e zgjeron dijen e përftuar në ciklin e ulët.

Tek lëndet e ciklit të ulët vijnë më tej edhe biologjia, fizika, amvisëria edhe të tjera. Cikli i lartë përgatit më tej nxënësit për arsimime profesionale ose për shkolla që çojnë më tej. Për tu përkrahur të rinjtë në mënyrë optimale, cikli i lartë, sipas komunave, ndahet në dy ose tre degë. Dega A është dega me kërkesa shumë të larta, dega B i merr të dobëtit, dega C i merr nxënëset dhe nxënësit më të dobët. Në secilën lëndë, komunat mund të krijojnë shkallë të ndryshme të kërkesave: Shkalla e kërkesave I është ndërkohë shkalla me kërkesa më të larta, shkalla e kërkesave III është shkalla me kërkesat më të ulëta.

Në fund të ciklit të lartë të rinjtë lirohen nga detyrimi shkollorë. Shumica kryejnë shkollimin profesional me shkollë të posaçme profesionale ose ata frekuentojnë një shkollë të mesme. Ose krahas shkollimit profesional ata mund të frekuentojnë edhe shkollën e mesme profesionale dhe të japin provimin e maturës, i cili u jep të drejtën për një studim në një shkollë të lartë ose në një shkollë të lartë profesionale.

Shkolla fillore publike dhe shërbimet e saj.

Vendi/zona i/e shkollës

Fëmijët e frekuentojnë shkollën në vendin ku ata banojnë. Nëse ata në ditët e javës zakonisht ndodhen jashtë zonës së tyre të banimit, atëherë ata duhet të shkojnë në shkollën e kësaj zone. Këshilli ndërmjetësues respektiv i shkollës së kësaj zone i ndan fëmijët nëpër shkolla. Ndarjen nëpër klasa dhe degë e bëjnë drejtoritë e shkollave.

Oraret e mësimit (orët bllok të mësimit) dhe strukturat ditore

Oraret e mësimit dhe të përkujdesjes zgjasin paradite prej orës 8 deri në orën 12. Për shkaqe organizative këshilli ndërmjetësues i shkollës, mund të bëjë shkurtimin e kësaj kohe maksimalisht deri në 20 minuta. Kohën e mesditës dhe mësimin e pasdites e rregullojnë komunat.

Koha e mesditës duhet të mjaftojë për të përmbledhur rrugën prej shkollës për në shpi dhe përsëri kthimin në shkollë si dhe marrjen e një vakti. Komunat përcaktojnë nevojën sipas strukturave të ditës (vaktin e drekës, familje për përkujdesje ditore, strehëza ditore në shkollë, shkolla gjithëditore, etj.).

Oferta plotësuese

Oferta plotësuese vullnetare janë shkollat e muzikës dhe kurset në gjuhën dhe kulturën e vendlindjes (HSK).

Shërbime përkrahëse

Këtu bëjnë pjesë shërbimet shkollore mjekësore, profilaksi i dhëmbëve, shërbimi psikologjik shkollore dhe puna sociale shkollore. Të gjithë fëmijët kontrollohen nga mjeku dhe dentisti.

Bashkëpunimi dhe përkrahja e ndërsjelltë

Qëllimi i përbashkët kryesor i shkollës fillore dhe i prindërve është arsimimi dhe edukimi i nxënësve. Kushtet e rëndësishme paraprake për suksesin shkollore të fëmijëve është puna e mirë e përbashkët në **trekëndëshin > Shkollë > Prindër > Nxënës**.

Shkolla i informon prindërit rregullisht për sjelljen dhe rezultatet e fëmijëve të tyre. Në raste të veçanta këshilli ndërmjetësues shkollore ose drejtoria e shkollës mund ta deklarojë si të detyrueshme vizitën në ndonjë takim prindëror.

Shkolla garanton bashkëpunimin e prindërve në mbrëmjet prindërore, tek arsimimi i prindërve, në javët e projekteve shkollore, në ditët e vizitave shkollore, tek krijimi i vendit për pushim etj.

Për këtë „bashkëpunim të përgjithshëm” prindërit janë të ftuar, por nuk mund të detyrohen. Prindërit nuk kanë të drejtë ndikimi në vendosjen e personelit të shkollës dhe në çështjet metodiko- didaktike.

Prindërit janë përgjegjës për edukimin e fëmijëve të tyre si dhe frekuentimin e rregullt të shkollës dhe përmbushjen e detyrimit shkollore. Ata informojnë mësuesët ose drejtorinë e shkollës, për sjelljen e fëmijëve të tyre si dhe për ngjarjet në rrethin e tyre dhe për atë që është me rëndësi për shkollën. Ata ndikojnë në vendimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me vetë fëmijën tyre, posaçërisht te vendimet e ecurisë shkollore.

Nxënëset dhe nxënësit përmbushin detyrimet e tyre dhe marrin pjesë aktive në funksionimin e shkollës. Ata marrin pjesë në vendimet që i prekin vetë ata, përderisa ata janë në moshën e duhur dhe s’ka ndonjë gjë që flet kundër kësajë. Shkolla fillore merr parasysh bashkëpërgjegjësinë dhe bashkërendimin e nxënësve dhe nxënësve në përshtatje të moshës dhe nivelit të tyre zhvillimor.

Ç`farë duhet bërë tek vështirësitë?

Mësuesit dhe prindërit informohen menjëherë reciprokisht. Për prindërit mësuesja e klasës ose mësuesi i klasës së fëmijës tuaj është personi i parë komunikues.

Nëse vështirësitë nuk mund të mënjanohen në bisedë me mësuesin, atëherë prindërit i drejtohen drejtorisë së shkollës. Nëse edhe këto kontakte nuk ndihmojnë, atëherë prindërit paraqiten tek organet lokale shkollore të këshillit ndërmjetësues të shkollës.

Kush mund t`Ju japë informacione?

Drejtoheni mësuesve të fëmijës Tuaj, adresën e të cilëve Ju e dini. Ose drejtoreshës ose drejtorit të shkollës. Administrata komunale e vendbanimit tuaj u shërben me gjitha informacionet e rëndësishme dhe shërbimet si mjeku i shkollës ose këshilli ndërmjetësues i shkollës.

Lokalitetet shkollore organizojnë në ditët e sotshme faqe interneti. Merrni Ju lutemi kohën dhe shikoni njëherë prezantimin në internet të shkollës "**Tuaj**"!

Mjetet e tjera informative.

.....
Informacione të plota Ju mund të gjeni në faqen e internetit të drejtorisë arsimore dhe autoriteteve të shkollës fillore:

www.bildungsdirektion.zh.ch

www.volksschulamt.zh.ch

Në faqen e internetit të autoriteteve të shkollës fillore gjenden numrat e telefonit të shërbimeve informative më të rëndësishme të autoritetit.

Bildungsdirektion
Volksschulamt
Walchestrasse 21
8090 Zürich
Tel. 043 259 22 51